



## REZULTATET E PRITSHME

- Të gjitha klasat e shkollës “Ismail Qemali” do të pajisen me panele ekologjike për pastrimin e ajrit në mjediset e brendshme.
- Nxënësit e tri shkollave do të angazhohen dhe përformojnë me ekspozitën tematike “ajër të pastër për shëndet më të mirë të fëmijëve”;
- Mësuesit angazhohen në përzgjedhjen e mjeteve didaktike si baze për dizinjinim e paneleve ekologjike.
- Autoritetet vendore, institucionet dhe aktor kyç në rajon, angazhohen për vazhdimin dhe implementimin e paneleve ekologjike në të gjitha shkollat e qytetit.



## QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Qëllimi:** Nxitja për një mjedis të shëndetshëm dhe cilësi më të mirë të ajrit të brendshëm për krijimin e modeleve pozitive dhe respektimin e të drejtave mjedisore dhe shëndetësore të fëmijëve në rajonin e Shkodrës.

### Objektivat:

1. Rritja e vetëdijes për parandalimin e sëmundjeve të frymëmarrjes, veçanërisht në mesin e nxënësve;
2. Promovimi i zgjidhjeve të reja ashtuquajtura “Frymë” drejt krijimit të modelit të mirë për një shëndet më të mirë të nxënësve tanë;
3. Pilotimi i paneleve ekologjike të pastrimit të ajrit të brendshëm në shkollën më të madhe të qytetit të Shkodrës për reduktimin e ndotësve të ajrit në mjediset e shkollave.

Në të njëjtën kohë kjo iniciative synon pilotimin e përdorimit të paneleve që ndikojnë në pastrimin e ajrit të brendshëm në ambientet publike. Pilotimi është planifikuar të bëhet në mjediset e shkollës “Ismail Qemali”, ku mësojnë 1215 nxënës dhe njihet si shkolla më e madhe në nivel kombëtar. Rezultatet e këtij pilotimi do të shërbejnë për vijimin e punës për përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm në ambientet publike.

# NXITJA E PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË AJRIT TË BRENDSHËM NË SHKOLLA PËR NJË SHËNDET MË TË MIRË TË FËMIJËVE TANË

*Ky projekt është financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri përmes programit EcoNord dhe zbatohet nga “Creative City” dhe “Gruaja në INTEGRIM”*



## INICIATIVA PËR PËRMIRËSIMIN TË CILËSISË SË AJRIT TË BRENDSHËM

Iniciativa për përmirësimin të cilësisë së ajrit të brendshëm në shkolla është mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri përmes programit EcoNord.

Kjo initiative erdhi si rrjedhojë e një studimi në nivel Evropian (iniciativa SEARCH pjesë e të cilit ishte edhe Shqipëria) mbi ndotjen e ajrit të brendshëm në ambientet e shkollave publike.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, Creative City në partneritet me shoqatën “Gruaja në INTEGRIM” dhe shkollën “Ismail Qemali” Shkodër, adresuan këtë problem për të nxitur autoritetet vendore në marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm në mjediset e shkollave me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

## CILËSIA E AJRIT TË BRENDSHËM

Cilësia e ajrit të brendshëm ndikon në mirëqenien e individit. Ai ka një gamë gjere efektsh shëndetësore si rezultat i pranisë së disa ndotësve të brendshëm që vijnë nga shkaqe dhe burime të ndryshme.

Cilësia e ajrit të brendshëm është shqetësim i veçantë kur është fjala për fëmijët. Karakteristikat e tyre fiziologjike dhe ato të sjelljes i bëjnë fëmijët veçanërisht të pambrojtur ndaj ndotësve mjedisorë!

Një pjesë e ndotësve të ajrit të brendshëm vijnë nga ajri i jashtëm, por shumica çlirohen brenda godinave, qofshin këto **mjedise banimi, mjedise shkollore, institucione publike, social-kulturore etj.**

Ekspozimi i fëmijëve ndaj ndotësve të brendshëm (si monoksidi i karbonit CO, dyoksidi i karbonit CO<sub>2</sub>, radoni, komponimet organike të avullueshëm VOC, etj), grimcave të ndotësve mikrobik (si myqeve, baktereve etj) janë shkaku kryesor i sëmundjeve të alergjive dhe atyre bronkiale; irritimit të membranave mukoze etj duke sjellë shpesh edhe dëmtime të rënda në shëndetin e fëmijëve.



## KONCEPTI “FRYMËMARRJE”

Koncepti “Frymëmarrje” përfaqëson një zgjidhje efikase, eficiente dhe ekonomik në eliminimin e helmuesve prezent në ajrin e ambienteve të mbyllura, falë shpërbërjes dhe përrthithjes pasive të ajrit nga panelet ekologjike që vendosen në ambiente të mbyllura.

Panelet ekologjike bëjnë të mundur ndarjen e molekulave të ndotura, që janë prezent në atmosferë, në mënyrë komplet PASIVE.

Për këtë arsye ky koncept i përfaqësuar nga panelet ekologjike është quajtur PRODUKT INOVATIV. Për të kryer efektin e vet, panelet ekologjike nuk kërkojnë ventilim, energji apo ndonjë gjë tjetër shtesë.

Prandaj kjo zgjidhje inovative ka ZERO ndikim në shpenzim energjie. Të tilla panele do të pilotohen për herë të parë në ambientet e shkollës “Ismail Qemali” në Shkodër.